



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Ne bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008"), nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, neneve 16, 17, 18, dhe 19 të Ligjit, Nr-02/L-53 për Gjuetinë, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-08/2007") nenit 8 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ të MA-Nr-10/2007, kriteret për caktimin e zonave të procedurave për themelimin e vendgjuetive, dhe bazuar në pëlqimin ref. ZSP.293/22 të datës 20.05.2022 të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Prishtinë, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën, 28.06.2022, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim themelohet vendgjuetia e përbashkët në territorin e Komunës së Dragashit, e emërtuar me emrin **"SHARRI"** me sipërfaqe të përgjithshme prej 19,395 ha, (sipërfaqe prej 10,132 ha në të cilën mund të kryhen aktivitete të gjuetisë), sipas hartës së bashkangjitur këtij vendimi dhe sipas procedurave të legjislacionit në fuqi.

Neni 2

Vendgjuetia nga neni 1, i këtij vendimi duhet të jetë e qëndrueshme që të shfrytëzohet sipas tërësisë së ekosistemit, baraspeshës ekologjike, kultivimit, mbrojtjes dhe shtimit të kafshëve të egra si pasuri natyrore kombëtare me interes të përgjithshëm që gëzon mbrojtje të veçantë në harmoni me dispozitat e nenit 19 pika 2, dhe nenit 34, të Ligjit, Nr-02/L-53, për Gjuetinë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-08/2007") dhe nenit 8, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ të MA-Nr-10/2007, kriteret e caktimit e zonave të procedurave për themelimin e vendgjuetive.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Turizëm, e Komunës së Dragashit.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Dragash, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008").

01-Nr- 060/01-13845-5/22
Datë 28.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit

Uran Halimi